



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS TABLE TENNIS FEDERATION OF KOSOVO

Ne baze te nenit 14 te Rregullores për reprezentacionet e pingpongut të Kosovës e në pajtim me nenin 27 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës Bordi i FPPK-së në mbledhjen e datës 18.01.2021 nxori Vendim që të publikoi këtë:

KONKURS

Për postin e Drejtorin e Përfaqësueses së Kosovës në pingpong

KUSHTET

Një person për t'u emëruar Drejtor i Perfaqesueses duhet të plotësoj këto kushte:

1. të jetë veprimtar i dalluar i sportit të pingpongut me rezultate kulminante në organizimin dhe udhëheqjen e sportit;
2. të ketë përgatitje superiore shkollore, preferohet fakulteti i edukatës fizike ose i certifikuar në njërin nga nivelet formale të ITTF për trajner;
3. të njeh një gjuhë botërore, përparësi i jepet gjuhës angleze;
4. mos të ketë rënë në kundërshtim me normat etike dhe morale dhe me parimet e Lëvizjes dhe Kartës Olimpike dhe të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale.

Përshkrimi i detyrave të Drejtorit të Përfaqësueses, përpilon:

- Propozimin e programit njëvjeçar dhe katërvjeçar të punës së reprezentacionit,
- Propozimin e planit të përgatitjeve të reprezentacionit,
- Propozimin e kalendarit të garave të reprezentacionit për sezonin e ardhshëm, duke marrë parasysh që garat lokale të jenë në funksion të paraqitjes sa më të suksesshme të reprezentacionit në gara ndërkombëtare,
- Propozimin e obligimeve të kandidatëve për reprezentacion për vitin e ardhshëm.

Vërteton propozimet për:

- listën e gjerë dhe të ngushtë të kandidatëve për reprezentacion,
- vendin, kohën dhe terminin e mbajtjes së përgatitjeve,
- reprezentuesit për lëvdata dhe shpërblime në bazë të rezultateve të arritura,
- trajnerët e ekipeve të përfaqësueses (meshkujve dhe femrave).

Udhëheq dhe koordinon:

- punën e të gjithë trajnerëve të reprezentacioneve dhe vërteton raportin me shkrim për punën e tyre (mujore dhe vjetore).
- Përgatitjet për paraqitjet e reprezentacionit,
- Përfaqësuesen gjegjëse në paraqitje në vend dhe jashtë vendit, me ç 'rast në bashkëpunim me trajnerin vendos për përbërjen e ekipit për gara ndërkombëtare,
- Përveç trajnerit, me punën e të gjithë personave tjerë të angazhuar për nevoja të reprezentacionit (udhëheqësi teknik i përgatitjeve, sekretari teknik i reprezentacionit, etj).
- Drejtor i Përfaqësueses përcjell përparimin dhe zhvillimin e lojtarëve të moshave të reja, kandidatëve potencial për reprezentacion, si dhe punën, rezultatet dhe formën e përfaqësueseve tjera.

- Në fund të sezonit garues Drejtor i Përfaqësueses i dorëzon Kuvendit raport me shkrim për punën dhe rezultatet në sezonin paraprak, me vlerësimin e rezultateve të arritura, si dhe vlerësimin e punës së të gjithë trajnerëve të angazhuar.
- Selektori është i pavarur në punën e tij. Për punën e tij Drejtor i Perfaqesueses i përgjigjet Bordit së FPPK-së.

MANDATI

- 4 vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat

AFATI I PARAQITJES

Afati i aplikimit është nga data **20.01.2021 deri me 20.02.2021.**

Aplikacioni i kompletuar duhet të përmbajë

- Cv
- Diploma universitare
- Certifikata për kryerjen e Nivelit I apo II për trajner ndërkombtar
- Dëshmi për punën aktive në tri vitet e fundit me gjeneratat e reja
- Dëshmi për rezultate të arritura
- Certifikatë për njohjen e gjuhës angleze
- Një përmbledhje të vizionit 4 vjeçar për punën me përfaqësuesen dhe ngritjen e cilësisë

Dokumentacioni i kompletuar duhet të të dërgohen në email adresën: **fppk@fppk.com** ose të shtypura në Zyren e FPPK-se..

Prishtine
20.01.2021

Bordi i FPPK